



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 520/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vllastimir Dimic dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Fryma e Re (FER) me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për shkak të parregullsisë gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 15.12.2010, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me nr. A-520, e datës 13.12.2010 e subjektit politik Fryma e Re

Arsyetim

Më 13 dhjetor 2010, PZAP-i ka pranuar një (1) ankesë, me numër A-520 të paraqitur nga FER në të cilën pretendohet se :

Në komunën e Dragashit, fshati Rrenc, shkolla fillore “Emin Duraku në VV 0526/01D rreth orës 11:30 persona të subjektit politik PDK kanë hyrë në këtë VV së bashku me dy fëmijë të veshur me mica me logo të PDK-së. Sipas parashtrueses se ankesës vëzhguesi i subjektit politik FER Albert Limani ka qenë në vendin e ngjarjes dhe ka raportuar disa emra si Avni Gërdellaj, Avni Skelaj, Dalip Loshaj, Agim Skelaj Ansen KAjpe dhe Adnan Berisha.

Ne mbështetje të pretendimeve, parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë prove.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parasheh si vijon:

3.6 (c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi te gjitha shkresat e lendes gjeti se:

- ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lendes PZAP vlerëson se ankesat e subjektit politik FER, ka mungesë të provave për t'u bindur se ka pasur parregullsi gjatë votimit si dhe nuk është ofruar asnjë provë si dëshmi bindëse për parregullsinë e pretenduar. Për këto arsye, dhe duke u bazuar ne dispozitat e lartpërmendura si dhe ne kuptimin e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

A nr. 520/2010 më datën 15.12.2010.

